

INCOSAI XX (DEKLARATA E JOHANESBURGUT)

Johanesburg, nëntor 2010

Organizuar nga Zyra Auditorit të Përgjithshëm të Afrikës së Jugut



Delegatë gjatë konferencës së njëzetë INCOSAI.

INCOSAI XX u mbajt në Johanesburg, Afrika e Jugut më datat 22-27 nëntor 2010, mbledhi së bashku 152 SAI, 500 delegatë, 104 drejtues SAI dhe 54 vëzhgues.

Sekretari i Përgjithshëm raportoi mbi zbatimin e Planit Strategjik 2005-2010 të INTOSAI-t dhe prezantoi Planin Strategjik 2011-2016, i cili u miratua nga kongresi. INTOSAI identifikoi prioritetet strategjike të mëposhtme për vitet e ardhshme: duke ndihmuar në sigurimin e pavarësisë së SAI-t, zbatimin e Standardeve Ndërkombëtare për Institucioneve Supreme të Auditimit (ISSAI), duke forcuar ndërtimin e kapaciteteve të SAI-ve, komunikimin e vlerave dhe përfitimeve të SAI-ve, si dhe luftën kundër korrupsionit.

Në këtë kongres u miratua Marrëveshja e Johanesburgut. Marrëveshja mbuloi diskutimet, përfundimet dhe rekomandimet e temës së parë (Vlerat dhe përfitimet e SAI-ve) dhe të temës së dytë (Auditimi mjedisor dhe zhvillimi i qëndrueshëm).

Progres pati gjithashtu edhe Iniciativa e Donatorëve, një përpjekje e rëndësishme ndërkombëtare për të rritur aftësitë e SAI-ve në vendet në zhvillim. Në një takim të mbajtur disa ditë para fillimit të kongresit, Komiteti Drejtues i Donatorëve të INTOSAI-t hartoi plane afatshkurtra dhe afatgjata për të zbatuar mandatin e tyre.

Kongresi miratoi 35 Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (ISSAI) dhe 2 Udhëzues të INTOSAI-t për mirë qeverisjen (INTOSAI GOV) të paraqitura nga Komiteti i Standardeve Profesionale.

U miratuan ndryshimet e mëposhtme në grupet e punës dhe task forcat e Qëllimit numër 3:

- Një Task Force mbi bazën e të dhënave të SAI-ve u krijua për të përpiluar një informacion të plotë në lidhje me komunitetin INTOSAI, duke krijuar kështu një bazë të dhënash për përdorim nga të gjithë anëtarët. Task Forca do të kryesohet nga SAI i Meksikës.

- Kongresi miratoi Udhëzuesin e Komunikimit të INTOSAI-it, të përgatitura nga Task Forca e Strategjisë së Komunikimit të INTOSAI-t. Kjo Task Force u shpërbë gjithashtu.

- Kongresi miratoi shpërbërjen e Grupit të Punës për privatizimin, rregulloret ekonomike, si dhe partneritetet publike-private.



SAI i Kinës gjatë prezantimit të temës së dyte, auditimi i mjedisit dhe zhvillimet e nevojshme.

Çmimi Kandutsch Jorg, i cila i është dhënë anëtarëve për zbatimin e qëllimeve të INTOSAI-t brenda grupeve rajonale të punës, iu dha SAI-t të Afrikës së Jugut.

Çmimi B. Elmer Staats, i cila është dhënë për artikullin më të mirë iu dha Egbert Jongsma dhe Frederik de Graaf nga Gjykata e Auditimit të Hollandës për artikullin e tyre "Përdorimi Geografik i Sistemeve të Informacionit gjatë Auditimit dhe përpjekjet për të luftuar pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit", botuar në Revistë në korrik të vitit 2008.